

<b>RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Projektligj ‘Për zhvillimin e ndërmarrjeve, mikro, të vogla dhe të mesme’
<b>MINISTRIA UDHËHEQËSE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Konsultim
<b>BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	I brendshëm
<b>DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së</b>	Jo e zbatueshme
<b>PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA</b>	Jo e zbatueshme
<b>DATA E KONSULTIMIT PUBLIK</b>	07/04/2021
<b>DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	29/03/2021
<b>A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT</b>	-jo
<b>NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	2021– MFE – Nr. VN
<b>TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)</b>	<a href="mailto:Eralda.shtylla@financa.gov.al">Eralda.shtylla@financa.gov.al</a> ; <a href="mailto:hava.delibashi@financa.gov.al">hava.delibashi@financa.gov.al</a> ;
<b>PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)</b>	

## **PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT**

*Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)*

Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka hartuar projektligjin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, nisur nga dy probleme kryesore:

1. Deri më sot, ka patur një interes të ulët në skemat e bashkëfinancimit të AIDA, për shkak të mungesës së informacionit nga bizneset, mënyra e aplikimit e cila ka qenë nëpërmjet postës dhe jo në formë elektronike, mungesa e shërbimeve mbështetëse për biznesin etj. Për këtë është vlerësuar shumë i nevojshëm rishikimi i kuadrit ligjor për mbështetjen e ndërmarrjeit për të qenë koherent me nevojat e tij. Asnjë mbështetje financiare direkte nuk ekziston në formën e granteve për kërkime dhe zhvillim (R&D), për më tepër mungojnë programet për të financuar drejtpërsëdrejti bashkëpunimin e ndërmarrjeve dhe akademisë edhe pse si ndërmarrjet si organizatat kërkimore kanë të drejtë të aplikojnë për thirrje për propozime pranë Agjencisë Kombëtare për Kërkim, Teknologji dhe Inovacion (të cilat janë të kufizuara në shumën e fondeve të ofruara për shkak të alokimeve të ulëta të buxhetit të shtetit). Referuar draft Raportit të Monitorimit të SEE 2020 të RCC për vitin 2019-2020, raportohet se gjenden statistika të besueshme dhe gjithëpërfshirëse për kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin (R&D dhe Inovacion) në shtetet e rajonit si Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, ndërkohe që tre ekonomitë e tjera të WB (Shqipëri, Kosovë dhe Bosnjë-Herzegovinë) nuk kanë bërë asnjë përparim në këtë fushë.
2. Ekzistenca e mangësive ligjorepër dhënien e fondeve nga AIDA për bizneset. Që prej vitit 2019, Ministria e Drejtësisë është shprehur kundër miratimit të projektvendimit të KM të propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, lidhur me krijimin dhe zbatimin e Fondit të Konkurrueshmërisë. Konkretisht dispozitat e referuara në projektakt nuk autorizojnë shprehimisht Këshillin e Ministrave për të nxjerrë një projektvendim me përmbajtje të tillë.

## **OBJEKTIVAT**

*Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)*

- Rritja e mbështetjes për NMVM-të me 50 %;
- Rritja e aplikimeve për teknologji të reja nga zero aktualisht në 50 % brenda vitit 2022.
- Rritja çdo vit e numrit të ndërmarrjeve të reja me , rritja e numrit të të punësuarve si edhe futja e instrumenteve të reja financiare me 10 %. respektivisht për cdo tregues.
- Rritja e shkallës e përthithjes së granteve me 100 % nga bizneset

## **OPSIONET E POLITIKAVE**

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)*

**Opsioni 0** - Ruajtja e status quo-së pa ndërhyrje në kuadrin ligjor ekzistues Ligji nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndermarrjet e vogla dhe te mesme”, i ndryshuar. Në këtë opsion mungojnë hapësirat ligjore për hartimin e skemave të garancisë shtetërore të huasë, për mbështetjen e kreditimit të ndermarrjeve.

**Opsioni 1** - Ndryshimi i ligjit nr. 8957, date 17.10.2002, “Për ndermarrjet e vogla dhe te mesme. Ky opsion nuk mundëson rregullimin e plotë të bazës ligjore për ofrimin e shërbime publike për ndermarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

**Opsioni 2-** Hartimi i një projektligji të ri për ndermarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. nje fjali  
Ky opsion parashikon hartimin e një projektligji të ri për zhvillimin e ndermarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat për nga dimensionet dhe karakteristikat kanë nevojë për një mbështetje financiare si edhe shërbime të reja mbështetëse të rregulluara me një akt ligjor.

## **ANALIZA E NDIKIMEVE**

*Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)*

Ndikimet e opsioni të preferuar janë te qeveria, bizneset, konsumatorët dhe qytetarët. Ndikimet monetare të përcaktuara lidhen me faktin se pas miratimit të këtij ligji, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme do të kenë një kuadër ligjor dhe institucional më të plotë, i cili iu përgjigjet nevojave të tyre. Masat mbështetëse për NMVM do të mirë përcaktohen me ligj, për të gjitha ndërmarrjet pavarësisht sektorëve ku operojnë. Në veçanti, referencat e reja ligjore që do të ngarkojnë organin e Këshillit të Ministrave, do të adresojë problematikat ligjore dhe do të lehtësojnë hartimin e politikave mbështetëse për ndërmarrjein dhe ekosistemin në vend.

Për herë të parë, mbështetja shtetërore për NMVM është e strukturuar në format si vijon:

- Mbështetje financiare nga buxheti i shtetit
- Mbështetje financiare nga donatorët vendas apo të huaj ;
- Garanci shtetërore të huasë sipas ligjit në fuqi për borxhin dhe garancitë shtetërore, në zbatim të politikave të veçanta të Qeverisë, në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale mbi qëndrueshmërinë e borxhit publik si dhe kufizimet e borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huave;
- Shërbime publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve në këtë ligj;

Draft ligji përcakton detyrimin e Agjensisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për të administruar një portal elektronik për instrumentet financiare të krijuara me fonde nga buxheti i shtetit dhe me donatorë. Cdo institucion që ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme ngarkohet që brenda 5 ditëve përpara fillimit të zbatimit të skemës të paraqesë një informacion pranë AIDA.

Mbështetja shtetërore nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse do të konsistojë në: 1) Sigurimin e informacionit, 2) këshillimit, 3) zhvillimit të biznesit, 4) trajnimit, 5) zhvillimit profesional apo ritrajnimit, 6) dhënien e shërbimeve metodologjike për ndërmarrjet si edhe personave fizikë që synojnë të krijojnë një ndërmarrje; si dhe 6) cdo informacion tjetër për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve.

## **ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR**

*Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta).*

**Opsioni 2** - Hartimi i një projektligji të ri për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme preferohet pasi i ofron një paketë ligjore të plotë ndërmarrjeve, të cilat për nga dimensionet dhe karakteristikat kanë nevojë për një mbështetje financiare si edhe shërbime të reja mbështetëse.

Në këtë mënyrë, nëpërmjet këtij projektligji, strukturohen dhe përcaktohen qartësisht gjithë masat mbështetëse për NMVM, financiare dhe mbështetëse publike, sikurse shpjeguar më lart, krijohet një bazë e plotë ligjore, duke përcaktuar procedurat e zbatueshme për përfitimin nga masat mbështetëse. Trajtimi sipas këtij projektligji, mbështet krijimin e ndërmarrjeve të reja, zhvillimin e tyre si edhe mundëson forma të reja të dhënies së mbështetjes financiare dhe jo financiare. Në këtë mënyrë, ndërmarrjeve u ofrohet ndihmë direkte dhe falas në mënyrë të vazhdueshme, të cilat nëse përthithen në mënyrën e duhur nga bizneset, do të arrië të kenë një rritje të shpejtë dhe të sjellin një impakt domethënës në rritjen e ekonomike dhe punësimin si edhe risi inovative të ndjeshme në mjedisin ekzistues të ndërmarrjeit ne vend.

Projektligji parashikon hartimin e skemave të garancisë shtetërore të huasë, që në rastet kur, për të mbështetur kreditimin e ndërmarrjeve, në zbatim të politikave të veçanta të Qeverisë, vendoset të lëshohet garanci shtetërore, Këshilli i Ministrave me vendim përcakton fondin, sektorët, kushtet dhe kriteret, për garantimin e huasë për mbështetjen e ndërmarrjeve, me propozim të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.

Për herë të parë përcaktohen të detajuara gjashtë llojet e masave të mbështetjes publike, shpjeguar më parë.

Nëpërmjet fuqizimit të rolit të AIDA nëpërmjet këtij ligji të ri, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme do të përfitojnë nga skemat e granteve të kombinuara me shërbime mbështetëse për sipërmarrjen falas, duke qenë se deri më sot, AIDA ofron financim për skemat për NMVM-të, por nuk ofron trajnime apo shërbime mentorime direkt për bizneset.

Projektligji do të mundësojë gjithashtu krijimin e një baze ligjore (të munguar deri më sot) për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Investimeve dhe Ndërmarrjeve. Me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, Këshilli i Ministrave miraton Strategjinë për Zhvillimin e Investimeve dhe të Ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Strategjia për zhvillimin e Investimeve dhe të Ndërmarrjeve përcakton vizionin, objektivat dhe përparësitë e promovimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve dhe rolin e njësisve të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes për zbatimin e Strategjisë. Programet vjetore përmbajnë projekte dhe iniciativa për zbatimin e Strategjisë gjatë vitit përkatës.

Gjithashtu në projektligj parashikohet ngritja dhe funksionimi i Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet si një organ këshillimor që ngrihet pranë institucionit përgjegjës për ekonominë, me përfaqësimin e organizatave të ndërmarrjeve si edhe institucioneve shtetërore.

**Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):**

<b>Viti 1</b>	<b>Viti 2</b>	<b>Viti 3</b>
747,533	78,969,545	78,969,545

## **KONSULTIMI**

*Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)*

Konsultimi do të bëhet me përfaqësues të biznesit dhe njësitë e qeverisjes qendrore dhe vetqeverisjes vendore. Konsultimi do të mbështetet në prezantimin e risive që sjell ky projektligj për adresimin e të gjitha nevojave të ndërmarrjeit, përfshirë mbështetjen financiare dhe diskutimin e formave për bashkëpunimin efektiv tyre dhe organeve shtetërore.

## **ZBATIMI DHE MONITORIMI**

*Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)*

Opsioni i preferuar parashikon përgatitjen e raporteve vjetore. Njësitë e qeverisjes qendrore dhe vetqeverisjes vendore detyrohen që, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të paraqesin pranë AIDA raporte vjetore për të gjitha skemat mbështetëse financiare dhe mbështetjen publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të dhëna.

Gjithashtu parashikohet që Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme do japë këshillim mbi mënyrën e hartimit të skemave mbështetëse për ndërmarrjein, sipas parashikimeve të këtij projektligji.

## **PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE**

### **Historik**

*Jepni kontekstin e politikës.*

Legjislacioni shqiptar në fuqi, parashikon një kuadër ligjor specifik, për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, i cili bazohet kryesisht tek Ligji nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, i ndryshuar<sup>1</sup>. Në vitet e kaluara, kuadri ligjor plotësohej nga një sërë vendimesh të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe urdhërave të ministrit përgjegjës, kryesisht të fokusuar tek fondet financiare për SME<sup>2</sup>.

Kuadri ligjor përfshin edhe strategjitë dhe organet e veprimit të miratuara ndër vite, të cilat ndikojnë mbi SME, të tilla si Strategjia e Zhvillimit të Ndërmarrjeit dhe Investimeve dhe Plani i Veprimit për periudhën 2014-2020<sup>3</sup>, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritimit për periudhën 2015 -2020<sup>4</sup>.

Bazuar në gjetjet e progress raportit të Komisionit të BE 2020 për Shqipërinë<sup>5</sup> “Në përgjithësi, kapaciteti thithës u përmirësua krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur 78% të aplikimeve dhe 92% të disbursimit të fondeve, ndërsa fondet mbeten të kufizuara. Asnjë fond nuk u shpërnda gjatë

<sup>1</sup> <https://aida.gov.al/sq/nvm/zbulo/baza-ligjore-nvm>

<sup>2</sup> <https://aida.gov.al/sq/nvm/iniciativat-e-financimit/fondet-e-aida-s>

<sup>3</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2014/10/01/635/b515875a-9b26-4f2f-b96a-dcf0951e4567;q=Strategjia%20e%20Zhvillimit%20te%20Biznesit%20dhe%20Investimeve%202014-2020>

<sup>4</sup> <https://kryeministria.al/strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim-2015-2020/>

<sup>5</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/albania_report_2020.pdf)

*gjysmës së parë të vitit 2020, pasi qeveria i orientoi përsëri fondet drejt masave të përgjigjes ndaj COVID për ndërmarrjeet. Aksesi në financa mbetet një sfidë serioze për ndërmarrjeet”.*

Referuar rekomandimeve të Komisionit Evropian për Programin e Reformave Ekonomike 2021-2023<sup>6</sup> është kërkuar që për zbutjen e pasojave ekonomike të pandemisë Covid-19 dhe stimulimin e rimëkëmbjes ekonomike, autoritetet shqiptare duhet të vendosin një mekanizëm efektiv dhe transparent për të mbështetur ndërmarrjeet e prekura nga kriza, në veçanti ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe të vetëpunësuarit. Gjithashtu kërkohet sigurimi i transparencës dhe parashikueshmërisë së masave, duke konsultuar legjislacionin e ri me ndërmarrjeet dhe partnerët socialë.

### **Problemi në shqyrtim**

1. *Përshkruani natyrën e problemit.*
2. *Identifikoni shkaqet e problemit.*
3. *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
4. *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
5. *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Referuar Rekomandimeve të Misionit të eksperteve të Komisionit Evropian, nënvizohet se megjithëse nivelet e financimit të SME kanë ardhur në rritje në këto vitet e fundit, gjithsesi konsiderohet i pamjaftueshëm për të nxitur një zhvillim të shpejtë të këtij sektori. Gjithashtu SME-të dhe sidomos SME-të e reja hasin mjaft vështirësi për të marrë kredi nga sektori bankar, ku kostoja e kredisë është relativisht e lartë. Kërkesat e bankave nuk janë të favorshme për ndërmarrjein, veçanërisht për nivelin e lartë të kolateralit dhe interesave të larta të kredisë. Ende mungojnë politika efektive mbështetëse për ndërmarrjeet e sapokrijuara. Deri në vitin 2019, mbështetja financiare në favor të SME është bazuar kryesisht nëpërmjet zbatimit të 4 (katër) fondeve, të cilat ofronin grante në mbështetje të SME, konkretisht 1. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë, 2. Fondi i Start up, 3. Fondi i ekonomisë kreative dhe 4. Fondi i Inovacionit. Në periudhën 2014-2019 të dhënat janë si vijon: Fondi i Konkurrueshmërisë kanë aplikuar 189 biznese, kanë fituar 126 biznese, dhe janë shperndare 134,778,680 lekë, pra shkalla e realizimit është 83.16%. Fondi i Start up kanë aplikuar 150 biznese, kanë fituar 95 biznese, dhe janë shperndare 34,635,564 lekë, pra shkalla e realizimit është 84.48%. Fondi i ekonomisë kreative kanë aplikuar 87 biznese, kanë fituar 77 biznese, dhe janë shperndare 37,236,944 lekë, pra shkalla e realizimit është 73.01%. Fondi i Inovacionit kanë aplikuar 92 biznese, kanë fituar 62 biznese, dhe janë shperndare 28,669,675, pra shkalla e realizimit është 66.60%. Gjithsej rezultati për fondet është se kanë aplikuar 518 biznese, kanë fituar 360 biznese, dhe janë shperndare 263,881,253 lekë, pra shkalla e realizimit është 73.58%. Fondet administroheshin nga AIDA, organ i cili kryente procedurat administrative që nga pranimi i aplikimeve, vlerësimi i tyre si edhe dhënie e mbështetjes ekonomike për subjektet fitues, në përfundim të procesit vlerësues (Konkurrueshmëria, Ekonomia Kreative (artizanati), Start-Up dhe Fondi i Inovacionit). Secili prej këtyre fondeve specifike vepron bazuar mbi rregullat e përgjithshme për funksionimin e tyre, të tilla si vlera e fondeve të akorduara (në total dhe për secilin vit të zbatimit të fondeve), kufijtë maksimalë të përfitimit për çdo SME, kostot e pranueshme, kushtet që duhet të plotësohen për përfitimin e fondeve, mënyrat e pagesave si edhe organet përgjegjëse për zbatimin e tyre<sup>7</sup>. Ndërkohë që procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloret përkatëse të funksionimit të fondeve, të miratuara nga ministri përgjegjës për ekonominë, psh kërkesa paraqitet në sportelin e AIDA-së nga vetë kërkuuesi apo çdo person i autorizuar prej tij sipas formatit të aplikimit, të miratuar nga Drejtori Ekzekutiv. Punonjësi i AIDA-

<sup>6</sup> <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Economic-Reform-Programme-2021-2023.pdf>

<sup>7</sup> <https://aida.gov.al/sq/nvm/iniciativat-e-financimit/fondet-e-aida-s>

e asiston të interesuarin në plotësimin e formularit të aplikimit, verifikon identitetin dhe kërkon nënshkrimin e formularit të plotësuar. Formulari i aplikimit duhet të plotësohet elektronikisht nga ana e nëpunësit të AIDA-s, sipas të dhënave të deklaruara nga aplikuesi. Dokumentet paraqiten në origjinal, në kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin ose në kopje të panjësuar me origjinalin, në përgjegjësinë e plotë të aplikantit për vërtetësinë e akteve të marra si kopje të vërteta të origjinalit<sup>8</sup>. Drejtori Ekzekutiv i AIDA miraton detajet teknike të tilla si formatet e aplikimit dhe aspektete teknike të procedurës administrative të AIDA. Deri më sot, ka patur një interes të ulët në skemat e bashkëfinancimit të AIDA, për shkak të mungesës së informacionit nga bizneset, mënyra e aplikimit e cila ka qenë nëpërmjet postës dhe jo në formë elektronike, mungesa e shërbimeve mbështetëse për biznesin etj. Për këtë është vlerësuar shumë i nevojshëm rishikimi i kuadrit ligjor për mbështetjen e ndërmarrjeit për të qenë koherent me nevojat e tij. Asnjë mbështetje financiare direkte nuk ekziston në formën e granteve për kërkime dhe zhvillim (R&D), për më tepër programe për të financuar drejtpërsëdrejti bashkëpunimin e ndërmarrjeit dhe akademisë edhe pse si ndërmarrjeet si organizatat kërkimore kanë të drejtë të aplikojnë për thirrje për propozime të Agjencisë për Kërkim, Teknologji dhe Inovacion (të cilat janë të kufizuara në shumën e fondeve të ofruara për shkak të alokimeve të ulëta të buxhetit). Referuar draft Raportit të Monitorimit të SEE 2020 të RCC për vitin 2019-2020, raportohet se gjenden statistika të besueshme dhe gjithëpërfshirëse për kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin (R&D dhe Inovacion) shtetet e rajonit si Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, ndërkohe që tre ekonomitë e mbetura të EB (Shqipëri, Kosovë dhe Bosnjë-Herzegovinë) nuk kanë bërë asnjë përparim në këtë fushë. Në disa shtete, të dhënat statistikore mbi treguesit kryesorë të R&D siç janë shpenzimet e brendshme bruto për R&D janë akoma të padisponueshme. Sipas raportit shpenzimet publike dhe private për R&D në rajon vazhduan të jenë të ulta, duke e bërë kapacitetin e kërkimit dhe inovacionit shumë të kufizuar. Pavarësisht nga mungesa e të dhënave për shpenzimet e brendshme bruto për R&D në raport me PBB-në për Shqipërinë dhe Kosovën, mund të vlerësohet se shpenzimet mesatare të rajonit për R&D të rajonit janë nën 0,4%, pesë herë më pak se mesatarja e BE-së, sipas tabelës së mëposhtme:

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
<b>EU</b>	2.03	2.03	2.04	2.03	2.07	2.19
<b>Albania</b>	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<b>Bosnia &amp; Herzegovina</b>	0.35	0.24	0.22	0.24	0.2	0.2
<b>Kosovo*</b>	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<b>Montenegro</b>	0.37	0.36	0.37	0.32	0.35	0.35
<b>N. Macedonia</b>	0.44	0.52	0.44	0.43	0.35	0.37
<b>Serbia</b>	0.68	0.78	0.87	0.89	0.93	0.92

Pavarësisht se ligji nr. 8957, date 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” ka disa dispozita dhe masa, të cilat lidhen me mbështetjen e ndërmarrjet<sup>9</sup>, nuk ka aktualisht një referencë të plotë ligjore për të ngarkuar Këshillin e Ministrave në nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore për zbatimin e neneve 5, dhe 8 të ligjit nr. 8957/2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, i ndryshuar. Gjithashtu, fondet që akordohen nga AIDA rezultojnë të jenë aktualisht të vetmet mekanizma mbështetëse të zbatuara në favor të SME. Referuar progres Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2020, për kapitullin 20 “Politikat industriale dhe ndërmarrjet” raportohet se “Në përgjithësi, kapaciteti thithës u përmirësua krahasuar me një vit më parë, duke arritur 78% të aplikimeve dhe 92% të disbursimit të fondeve, ndërsa fondet mbeten të kufizuara. Asnjë fond nuk u shpërnda gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, pasi qeveria i orientoi përsëri fondet drejt masave të përgjigjes ndaj COVID për bizneset”. Referuar raportit të fundit të OECD Small Business Act të

<sup>8</sup> <https://aida.gov.al/sq/nvm/iniciativat-e-financimit/aplikim-per-grante>

<sup>9</sup> <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2002/10/17/8957/5647af43-a5dd-45db-9329-f60860fc4a2d;q=ligji%20per%20ndermarrjet%20e%20vogla%20dhe%20te%20mesme>



OECD 2019 për 6 vëndet e Ballkanit Perëndimor ËB6, në dimensionin e “Aksesit në Financë”, nënvizon se “Kapitali sipërmarrës është ende në fillimet e tij në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, megjithëse disa investime fillestare të fondeve të sipërmarrjeve u zhvilluan në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë gjatë periudhës raportuese. Nivelet e edukimit financiar mbeten të ulta. Përpjekjet e sektorit publik dhe privat për të rritur më shumë njohuritë financiare midis bizneseve dhe popullatës së gjerë përgjithësisht mbeten të shpërndara dhe të pakoordinuara, dhe të gjitha ekonomive të ËB6 u mungon a një qasje e qartë strategjike për të trajtuar mangësitë në këtë fushë. Në përgjithësi, Turqia mbetet performuesi më i fortë dimensionin e “Aksesit në Financë”, i ndjekur nga Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova të gjitha performojnë në mënyrë të ngjashme, me rezultati mesatar që varion midis 3.26 dhe 3.33, më poshtë se mesatarja e rajonit 3.53.”. Në lidhje me sa më lart, është i nevojshëm krijimi i mekanizmave ligjore për të mundësuar krijimin dhe monitorimin e masave mbështetëse për ndërmarrjen. Grupet e prekura janë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme pasi duhen mbështetur për zhvillimin e tyre, duke zgjeruar aktivitetin në treg dhe përmirësuar cilësinë e produkteve/shërbimeve dhe rritjen e avatazheve konkurruese. Gjithsej numërohen rreth 108,020 ndërmarrje SME (duke punësuar 354,967 punonjës), nga këto 94,945 janë mikrondërmarrje (punësuar 174,303.67 punonjës), 8,738 janë ndërmarrje të vogla (punësuar 66,527.11 punonjës) dhe 4,337 janë ndërmarrje të mesme (punësuar 114,136.91 punonjës) Referuar të dhënave të INSTAT, regjistri i ndërmarrjeve në fund të vitit 2019 numëron 162.342 ndërmarrje aktive, numër pothuajse i njëjtë me vitin e kaluar. Ekonomia shqiptare është e përqëndruar kryesisht në aktivitetin tregtar, dukuri e cila vihet re edhe në ndërmarrjet e regjistruara gjatë vitit 2019. Ndërmarrjet tregtare zënë 23,0 % të ndërmarrjeve të regjistruara gjatë vitit 2019, krahasuar me 23,2 % të regjistruara gjatë vitit 2018. Gjithashtu është i nevojshëm rregullimi me dispozita ligjore dhënia e mbështetjes me grante financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në vend. Deri në vitin 2019, në kuadër të hartimit të projektakteve për mbështetjen e biznesit janë hasur vështirësi gjatë shqyrtimit dhe miratimit të tyre në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë nga ana e ministrisë përgjegjëse për ekonominë. Referuar pergjigjeve zyrtare të dhëna nga Ministria e Drejtësisë, jemi informuar se prej MD janë konstatuar disa mangësi ligjore. Konkretisht dispozitat e referuara nga neni 5 dhe 6 të ligjit ekzistues nr. 8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, i ndryshuar” janë me natyrë deklarative, dhe nuk e autorizojnë shprehimisht Këshillin e Ministrave për të nxjerrë një projektvendim me përmbajtje të tillë. Gjithashtu Ministria e Drejtësisë ka sugjeruar se ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e aktit nënligjor, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar si edhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. Të gjitha këto vërejtje duhen adresuar në projektligjin e ri që po propozohet nëpërmjet kësaj RIA. Përfitimet prekin ndërmarrjeet, duke i fokusuar ato tek modelet dhe produktet e reja të ndërmarrjeit ndërkohë që produktet dhe shërbimet e reja, sjellin avantazhe edhe për qytetarët dhe konsumatorët Duke qenë se bizneset do të përfitojnë nga ofrimi i mbështetjes financiare dhe shërbime të tjera mbështetëse do të mund të realizojnë më shumë shitje dhe të rrisin volumin e tyre të transaksioneve. Përmirësimi i kushteve të të bërit biznes do të ndihmojë bizneset për tërheqjen e klientëve dhe konsumatoreve të rinj në treg. Situata aktuale për aksesin në financë në vend paraqitet problematike: Akses i kufizuar në financa - vetëm 40% e të rriturve dhe rreth 75% e NVM-ve kanë llogari bankare; Vetëm 1% e NVM-ve në Shqipëri përdorin grante buxhetore, pra rreth 3 herë më e pak se mesatarja e vendeve të tjera të rajonit; Akses i kufizuar në shërbimet mbështetëse për biznesin; Ka mungesë njohurish për sipërmarrjen dhe fushën e teknologjisë; Ka një mospërputhje midis aftësive të disponueshme në treg dhe ato të nevojshme të fuqisë punëtore; Zbatimi i dobët i ligjit sidomos në lidhje me zbatimin e kontratave; Perceptimi i lartë i korrupsionit; Lidhjet e furnizimit me energji elektrike të kufizuara (parandalon zhvillimin e biznesit); Akses i kufizuar në informacion.

## Arsyeja e ndërhyrjes

6. *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
7. *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
8. *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
9. *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Kriza e shkaktuar nga pandemia Covid-19 përbën një sfidë të madhe për ekonominë botërore si dhe atë shqiptare. Kriza po përshpejton një sërë tendencash kryesore duke ndikuar fuqishëm konfigurimin e zinxhirit të vlerave ndërkombëtare. Transformimi pritet të vazhdojë, i nxitur nga: Ndryshimet teknologjike, p.sh tranzicioni digjital dhe prodhimi me teknologji të avancuar; Tendencat botërore të qeverisjes ekonomike; Tendencat e qëndrueshmërisë. Me qëllim rritjen e rezistencës ndaj goditjeve në të ardhmen, kompanitë po ndryshojnë burimin e sigurimit të produkteve dhe vendndodhjen e veprimtarisë. Pavarësisht sfidave të ndryshme, të tilla si ngushtimi i hapësirave për investime efikase, transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare do të shpallë gjithashtu mundësi të mëdha për zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe riindustrializimin e qëndrueshëm në të ardhmen, duke përfshirë: Tërheqjen e projekteve në vendet e afërta: Investitorët që operojnë në vendet e BE-së pritet që të përqendrojnë më shumë aktivitete në afërsi të vendit të tyre të origjinës, veçanërisht në zinxhirin e vlerave që lidhen me teknologjinë e lartë si pajisjet elektronike, makineritë dhe pajisjet që krijojnë mundësi për zhvillimin e industrive dhe tregjeve të reja. Sa më lart, aktualisht është në proces draftimi Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027, e cila po adreson shfrytëzimin e mundësive për një qasje të targetuar dhe koherente: Përqendrimi në zinxhirët e vlerave që ofrojnë mundësitë më të mëdha, duke marrë në konsideratë procesin e transformimit; Shpallja e plotë e potencialit investues për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm; Vendosja e theksit në zhvillimin e ekosistemeve dinamike industriale, inovative dhe sipërmarrëse; Rritja e efektivitetit të skemave mbështetëse për sipërmarrësit dhe NVM-të, si shtylla e ekonomisë shqiptare; Zhvillimi përmes rrugëve më inovative dhe të bazuara në njohuri, me në fokus rritjen e cilësisë dhe të punësimit; Eksplorimi i mënyrave të reja për të nxitur zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues. Hartimi i një projektligji të ri për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme është i nevojshëm, pasi kuadri ligjor ekzistues nuk ofron referencën e duhur ligjore për mbështetjen e ndërmarrj. Ky projektakt ka të nevojshëm reflektimin e të gjitha rekomandimeve të dërguara nga Komisioni Evropian dhe OECD. Draftligji i ri ruan të njëjtin përkufizim të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme sipas Rekomandimit të KE së maj 2003<sup>10</sup> Për qëllime statistikore ndërmarrjet do të klasifikohen në: mikrondërmarrje: 0 deri 9 persona, ku brenda këtij grupimi të detajohen në 0-1 persona dhe 2-9 persona; ndërmarrje të vogla: 10 deri 49 persona; ndërmarrje të mesme: 50 deri 249 persona. . Ai përcakton klasifikimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme mbi bazën e kriterëve të reja të përcaktuara saktësisht në Rekomandimin 2003/361/EC. Përkufizimi prezanton tre kategori të ndryshme të ndërmarrjeve, të cilat janë “Ndërmarrje autonome” është çdo ndërmarrje, e cila nuk klasifikohet si ndërmarrje partnere në kuptimin e pikës 2, të këtij neni ose si ndërmarrje e lidhur në kuptim të pikës 3, të këtij neni. “Ndërmarrje partnere” janë të gjitha ndërmarrjet që nuk klasifikohen si ndërmarrje të lidhura në kuptim të pikës 3, të këtij neni dhe midis të cilave ekziston marrëdhënia si vijon: një ndërmarrje mban, ose vetëm ose së bashku me një ose më shumë ndërmarrje të lidhura në kuptim të pikës 3, të këtij neni, 25 % ose më shumë të kapitalit ose të drejtave të votës së një ndërmarrje tjetër. “Ndërmarrje të lidhura” janë ndërmarrjet që kanë një nga lidhjet e mëposhtme: një ndërmarrje ka shumicën e të drejtave të votave të aksionarëve ose anëtarëve në një ndërmarrje tjetër; një ndërmarrje ka të drejtë të emërojë ose largojë shumicën e anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese ose mbikëqyrëse të një ndërmarrje tjetër; një ndërmarrje ka të drejtë të ushtrojë një ndikim dominues mbi një ndërmarrje tjetër, në bazë të një kontratë të lidhur me atë ndërmarrje ose të një përcaktimi në memorandum apo nenet e statutit; një ndërmarrje, e cila është aksionare ose anëtare e një ndërmarrje tjetër, kontrollon e vetme, në përputhje me një marrëveshje me aksionarët e tjerë ose anëtarët e asaj ndërmarrjeje, shumicën e të drejtave të votave të aksionarëve ose anëtarëve në atë ndërmarrje. e cila prej tyre i korrespondon një tipi marrëdhëniejeje që një ndërmarrje mund të ketë me një tjetër. Ky dallim është i nevojshëm në mënyrë që të krijojë një tablo të qartë të situatës

<sup>10</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32003H0361>

ekonomike të ndërmarrjes dhe të përjashtojë ato që nuk janë vërtetë SME. Me tu klasifikuar si “ndërmarrje” sipas përkufizimit të dhënë në këtë projektligj, ndërmarrja duhet të plotesoje të dhënat e saj në përputhje me kriteret e mëposhtme: Numri i të punësuarve dhe Shifra e afarizmit ose Bilanci total vjetor. Krahasimi i të dhënave me pragjet e përcaktuara në këtë nen, bën të mundur kategorizimin e ndërmarrjes si një ndërmarrje mikro, e vogël apo e mesme. Ndërkohë që projektligji i qëndron strikt kriterit të parë (numrit të të punësuarve), rekomandimi 2003/361/EC, lejon hapësirë përse i përket kriterit financiar, duke marrë parasysh edhe kapacitetin dhe performancën e zhvillimit të ndërmarrjeit në vendin tonë. Kriteret financiare janë mbajtur të pandryshuar nga ligji i vitit 2002 dhe janë vlerësuar si të përshtatshme edhe në drejtim të rritjes së mundësisë së mbështetjes së këtyre ndërmarrjeve nga masat mbështetëse shtetërore. Ky përkufizim do të ndihmojë në hartimin e akteve të tjera nënligjore për mbështetjen e atyre kategorive të ndërmarrjeit të cilat kanë më shumë nevojë për një masë të caktuar mbështetëse në një sektor të caktuar të ekonomisë. Gjithashtu ndërhyrja do të mundësojë dhënien e shërbimeve mbështetëse shtesë për ndërmarrjein falas. Shërbimet publike që do të jepen nga Agjensia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe përfshijnë kryesisht: Sigurimin e informacionit, këshillimit, zhvillimit të biznesit, trajnimit, zhvillimit profesional apo ritrajnimit, dhënien e shërbimeve metodologjike për ndërmarrjet si edhe personave fizikë që synojnë të krijojnë një ndërmarrje; Cdo informacion tjetër për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve. Do të mundësohet një formë më e mirë e monitorimit të zbatimit të politikave mbështetëse për ndërmarrjet si edhe sigurohet një transparencë në vendimarrje. Projektligji parashikon se njësitë e vetqeverisjes vendore kur japin mbështetje shtetërore financiare duhet të përcaktojnë qartë procedurën për ofrimin e mbështetjes për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, procedurë e cila duhet të jetë e njëjtë për të gjitha ndërmarrjet që përfitojnë mbështetjen shtetërore. Gjithashtu projektligji parashikon se njësitë e qeverisjes qendrore dhe vetqeverisjes vendore detyrohen që, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të paraqesin pranë AIDA raporte vjetore për të gjitha skemat mbështetëse financiare dhe mbështetjen publike për ndërmarrjet. Ndërhyrja synon të krijojë një mjedis të përshtatshëm për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, duke krijuar kuadrin ligjor dhe institucional si edhe duke detajuar mekanizmat e mbështetjes shtetërore. Nga ana tjetër kjo nisimë favorizon krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe adresimin e modeleve të reja të ndërmarrjeit. Ministria e Ekonomisë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kroaci së fundmi ka publikuar një Thirrje për projekt propozime “Forcimi i konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve duke investuar në tranzicionin dixhital dhe të gjelbërt”. Kjo thirrje do të mbështesë investimet e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në teknologji të gjelbërta dhe / ose dixhitale dhe në këtë mënyrë forcon konkurrueshmërinë dhe stimulon rritjen e NVM-ve me qëllim që të rritet aftësia e tyre për t’iu përgjigjur sfidave të tregut të shkaktuara nga pandemia e COVID-19. Vlera totale e thirrjes është 1,140,000,000.00 HRK. Propozimet e projekteve dorëzohen në mënyrë elektronike përmes sistemit eFondovi. Shuma maksimale totale e granteve që mund t’u jepen sipërmarrësve individualë është 7,500,000.00 HRK për projekt propozim, dhe shuma më e ulët e granteve që mund të jepen për projekt propozim është 500,000.00 HRK<sup>11</sup>. Për këto arsye, është e nevojshme hartimi i këtij projektligji të ri. Duke konsideruar objektivat e strategjive të miratuara, projektligji implementon objektivat dhe prioritetet e draft Strategjisë së re të Zhvillimit të Ndërmarrjeit dhe Investimeve 2021-2027, e cila përcakton se do të hartohen politika të reja mbështetëse për ndërmarrjeet nëpërmjet krijimit të burimeve financiare alternative si garancitë financiare, kapital risku -venture capital, skema voucher për inovacionin - innovation vouchers, engjëj ndërmarrjei - business angels, etj. Konkluzioni mbi nevojën e kryerjes të disa rishikimeve në kuadrin ekzistues ligjor ka ardhur si pasojë e analizës së nevojave të ndërmarrjet, rekomandimet e Komisionit Evropian si edhe nga opinionet dhe kërkesat e marra nga vetë komuniteti i ndërmarrjeve dhe subjekteve që ofrojnë mbështetje për ndërmarrjeet në Shqipëri. Puna ekzistuese, përtej konsultimit me ta, ka përfshirë edhe analizën e modeleve dhe praktikave më të mira si edhe opinionet e ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendas, cka ka sjellë në hartimin e këtij projektligji të ri. Në shtator 2020, MFE përfitoi nga nje mision 2 ditor i dy eksperteve të BE. Konkluzionet e takimit ishin: Ridizenjimi i skemave mbështetëse për SME . Ridizenjimin e skemave të granteve shtetërore për të mbështetur NVM-të dhe për të përmirësuar aksesin në financa; Dhënien e ndihmës për NVM-të që kriza e COVID të mos dëmtojë aktivitetin e tyre; Konceptimin e thirrjeve efektive për propozime me kushte, kriteret

<sup>11</sup> <https://investcroatia.gov.hr/en/publication-of-the-call-for-the-delivery-of-the-project-proposals-strengthening-the-competitiveness-of-companies-by-investing-in-the-digital-and-green-transition/>

përzgjedhje të përmirësuara; Procedurë aplikimi dhe monitorimi më i thjeshtë; Identifikimi i subjekteve të përshtatshme për t'u mbështetur; Krijimi i treguesve më të mirë për të matur performancën . Rekomandime për grantet e reja për SME-të: Informacioni për të gjitha grantet për NVM-të duhet të jetë i qëndërzuar; Infrastruktura e mbështetjes së NVM-ve duhet të jetë më e gjerë – duke konsideruar mbështetjen edhe në nivele rajonale/lokale;p.sh. bashkëpunimi me dhomën e tregtisë, qendrat e inovacionit etj.) ose në krijimin e agjencive të zhvillimit rajonal, përshejtuesve të biznesit, inkubatorëve të biznesit etj; Programet e trajnimit (të akredituara) për NVM-të duhet të sigurohen nga partnerët me koordinimin e AIDA - të nevojshme për krijimin e lidhjeve të AIDA dhe partnerë në ekosistemin e biznesit; Analizë e rregullt e nevojave të NVM-ve për programe të caktuara - nëse ka interes më të ulët atë vit, rekomandohet rialokimi i fondeve për të mbështetur ato programe që janë më atraktive për NVM-të; Procesi i aplikimit për skemat e reja të granteve duhet të dixhitalizohet (duhet të rritet numri i aplikantëve të mundshëm); Skema e granteve duhet të lidhet me dokumentet strategjike (të cilat janë në proces) Madhësia e granteve të disponueshme për projekte në fondet aktuale të disponueshme nuk i stimulon NVM-të, prandaj duhet të rriten Ka një mungesë të njohurive teknike në NVM për të shkruar propozimin e projektit / planin e biznesit – ndaj duhet konsideruar përfshirja e një kostoje të tillë në listën e kostove të pranueshme në thirrje; Kostoja e pajisjeve duhet të jetë një kosto e pranueshme.Çmimi i pajisjeve nuk mund të tejkalojë vlerën e saj të tregut ose koston e pajisjeve të reja të ngjashme Pajisjet duhet të kenë karakteristikat teknike të nevojshme për funksionimin; Kriteret e vlerësimit duhet të përcaktohen në dokumentet e programit – me qëllim rritjen e transparencës në përzgjedhjen e fondeve .

### **Objektivi i politikës**

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
3. *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

- Rritja e mbështetjes për NMVM-të me 50 %;
- Rritja e aplikimeve për teknologji të reja nga zero aktualisht në 50 % brenda vitit 2022.
- Rritja çdo vit e numrit të ndërmarrjeve të reja me , rritja e numrit të të punësuarve si edhe futja e instrumenteve të reja financiare me 10 %. respektivisht për cdo tregues.
- Rritja e shkallës e përthithjes së granteve me 100 % nga bizneset

### **Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara**

1. *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
2. *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
3. *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

**Opsioni 0** - Ruajtja e status quo-së pa ndërhyrje në kuadrin ligjor ekzistues Ligji nr. 8957, date 17.10.2002, “Për ndermarrjet e vogla dhe te mesme”, i ndryshuar. Ky opsion nënkupton mosndërmarrjen e asnjë politike, duke vijuar me funksionimin e legjislacionit aktual, pa dispozita konkrete dhe specifike për nxitjen e krijimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Ky opsion nuk ofron kosto shtesë, por nga ana tjetër nuk ofron asnjë avantazh krahasuar me gjendjen ekzistuese dhe pamundëson dhe vonon reagimin e qeverisë ndaj kërkesave të tendencave të tregut që lidhen me zhvillimin e ndërmarrjeit.

**Opsioni 1** - Ndryshimi i ligjit nr. 8957, date 17.10.2002, “Për ndermarrjet e vogla dhe te mesme”, i ndryshuar. Ky opsion mund të ndërmerret, por nuk krijon një vlerë të shtuar në kuadrin ligjor për krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe nuk adreson problematikat aktuale të ndërmarrjeit si edhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.Ndryshimet që mund të shtohen në ligjin ekzistues nr. 8957, date 17.10.2002, “Për ndermarrjet e vogla dhe te mesme”, i

ndryshuar, nuk do të mund të jenë harmoni me pjesën tjetër të ligjit. Kështu psh nëse shtohen parashikimet mbështetëse për biznesin, këto nuk reflektohen me pjesën se cilat janë detyrimet për sigurimin e transparencës dhe monitorimin e shërbimeve të ofruara nga të gjitha organet e qeverisjes shtetërore.

**Opsioni 2-** Hartimi i një projektligji të ri për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Ky opsion është më i favorshëm se opsioni 0 dhe 1, pasi krijon një bazë të plotë ligjore për mbështetjen financiare dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për ndërmarrjet, pamvarësisht nga sektorët ku operojnë. Gjithashtu ofrohet një sistem më i mirë monitorimi për zbatimin e të gjithë politikave për zhvillimin e ndërmarrjeve, duke shtuar edhe mekanizmin e ri atë të Këshillit Konsultative për ndërmarrjet që pritet të sigurojë transparencë të lartë në vendimmarrje për politikat e zhvillimit të ndërmarrjeve. Në këtë RIA, kemi llogaritur si kosto për buxhetin e shtetit koston për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në formën e mbështetjes financiare dhe shërbime mbështetëse (trajnim, këshillim) . Në vitin e parë janë parashikuar kosto gjithsej 13, 012, 733 lekë, e cila përfshin organizimin e ëëbinareve për e-business, krijimin e Sektorit të Trajnimeve me 3 punonjës të rinj në strukturën e AIDA, zhvillimin e sistemit të parashikimit të aftësive për bizneset. Në vitin e dytë janë parashikuar kosto gjithsej 99, 369, 454 lekë, e cila përfshin krijimin e portalit për e-business (që shpjegon se çfarë duhet të marrin parasysh kompanitë kur miratojnë zgjidhjet e tregtisë elektronike dhe të biznesit elektronik), grante për ofrimin e trajnimeve dhe mbështetje financiare për ndërmarrjet e sapokrijuara, grante për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si edhe hartimin e raporteve vjetore për parashikimin e nevojave për aftësim nga bizneset. Në vitin e tretë deri në vitin e dhjetë janë parashikuar kosto gjithsej 93, 369,545 lekë, e cila përfshin dhënien e mbështetjes financiare si edhe shërbime mbështetëse për biznesin. Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik si përgjegjëse e hartimit të politikave mbështetëse për biznesin ka kuantifikuar përfitimet për biznesin në direkte (grantet) dhe indirekte (organizimi i trajnimeve, zhvillimi i aftësive etj). Parimi i “*Value for money*” është përdorur për llogaritjen e efikasitetit dhe efektivitetit maksimale për çdo lekë të planifikuar dhe shpenzuar nga buxheti i shtetit. (me shkallën e përfitimit nga biznesi që pritet të jete maksimale në 100 %). Përfitimet në shërbime mbështetëse për biznesin nëpërmjet dijeve, njohurive, aftësive , do të përthithen prej tyre, të cilat në mënyrë direkte reflektohen në të ardhmen. Vlera prezente aktuale e koston në total është 684 mln lekë, ndërsa vlera prezente aktuale e përfitimit në total është 684 397 000 lekë, duke llogaritur Vlerën Prezente Neto Aktuale (VAN) në shumën prej 0 lekë. Theksojme se ky opsion nuk ka disavantazhe.

### **Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve**

1. *Identifikoni grupet e prekura.*
2. *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
3. *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
  1. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  2. *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
  3. *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
  4. *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
4. *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
  1. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  2. *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
5. *Diskutoni kufizimin e analizës:*
  1. *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*

2. *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
6. *Përmblihdni vlerësimin e opsioneve:*
1. *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
  2. *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
  3. *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Në grupet e personave që preken nga përfitimet e lidhura janë edhe konsumatorët, qytetarët dhe vetë qeveria, të cilët gëzojnë efektet e zbatimit të politikave mbështetëse për ndërmarrjein dhe formalizimin e ekonomisë, duke mundësuar regjistrimin e tyre në regjistrin tregtar dhe në sistemin e kontribuesve tatimpagues. Projektligji prek ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të sapokrijuara dhe ekzisuese, si dhe institucionet shtetërore që ofrojnë shërbime mbështetëse për ndërmarrjet (përfshirë të gjitha ministritë e linjës dhe njësitë e vetqeverisjes vendore) si edhe konsumatorët, punonjësit e bizneseve . Gjithsej numërohen rreth 108,020 ndërmarrje SME (duke punësuar 354,967 punonjës), nga këto 94,945 janë mikrondërmarrje (punësuar 174,303.67 punonjës), 8,738 janë ndërmarrje të vogla (punësuar 66,527.11 punonjës) dhe 4,337 janë ndërmarrje të mesme (punësuar 114,136.91 punonjës) Ndikimet e drejtpërdrejta për këto subjekte lidhen me rritjen e aksesit në financa nëpërmjet granteve buxhetore, shërbimeve mbështetëse për biznesin si : sigurimi i informacionit, këshillimit, zhvillimit të biznesit, trajnimit, zhvillimit profesional apo ritrajnimit, dhënien e shërbimeve metodologjike për ndërmarrjet si edhe personave fizikë që synojnë të krijojnë një ndërmarrje , në këtë mënyrë krijimin e një mjedisi rregullator më të favorshëm për biznesin. Përtej tyre, projekt ligji sjell përfitime për ndërmarrjet ekzistuese, duke i këshilluar dhe trajnuar ato që të adresohen drejt produkteve dhe shërbimeve të përmirësuara në treg dhe krijuar avatazhe konkurruese. Ndikime të drejtpërdrejta për biznesin janë: mbështetja me grante për biznesin. Ndikime jo të drejtpërdrejta për biznesin janë: rritja e njohurive, përmirësimi i produkteve dhe shërbimeve, rritja e qarkullimit në të ardhmen, si edhe një rritje e kulturës së sipërmarrjes. Ndikime të drejtpërdrejta për qeverinë janë: rritja e shpenzimeve nga buxheti i shtetit. Ndikime jo të drejtpërdrejta për qeverinë janë: Rritja e numrit të bizneseve të reja, rritja e numrit të punësuarve, rritja e të ardhurave në buxhetin e shtetit si rezultat i të hyrave nga tatim/taksat si rezultat i një aktiviteti më të lartë ekonomik. Ndikime të drejtpërdrejta për konsumatorët dhe qytetarët janë: produkte dhe shërbime më cilësore dhe inovative në treg. Ndikime jo të drejtpërdrejta për konsumatorët dhe qytetarët janë: rritja e punësimit dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës.

### **Arsyetimi i opsionit të preferuar**

1. *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
  2. *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*
1. Opsioni 2- Hartimi i një projektligji të ri për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ky opsion krijon kuadër të plotë ligjor mbështetës për nxitjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, duke autorizuar Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e akteve të tjera nënligjore në mbështetje të NMVM-ve. Gjithashtu ky opsion mundëson arritjen e përfitimeve nga diversifikimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare. Ndër të tjera, në industri me teknologji të ulët si ajo e tekstileve dhe modës, por edhe në industri shërbimesh me vlerë më të lartë, shërbimet që do të ofrohen ndërmarrjeve, nëpërmjet ofrimit të informacionit dhe granteve financiare, do të mundësojnë bizneseve diversifikimin e aktiviteteve të tyre duke i shtojtur me zgjidhjet digjitale. Përveç mundësive për investime të reja, ky opsion ofron mundësi të mira për integrimin e NMVM-ve vendase dhe sipërmarrësve në zinxhirin e vlerave ndërkombëtare. Gjithashtu ky opsion mundëson shfrytëzimin e mundësive që lidhen me kalimin e bizneseve në ekonominë e gjelbër. Ky opsion preferohet gjithashtu se siguron mundësi premtuese për investime dhe inovacion në të gjithë sektorët e industrisëProjektligji parashikon

hartimin e skemave të garancisë shtetërore të huasë duke ngarkuar Këshillin e Ministrave për përcaktimin me vendim për fondin, sektorët, kushtet dhe kriteret, për garantimin e huasë për mbështetjen e ndërmarrjeve, me propozim të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për ekonominë. Projektligji do të mundësojë krijimin e bazës ligjore (të munguar deri më sot) për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Investimeve dhe Ndërmarrjeve. Me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, Këshilli i Ministrave do të miratojë Strategjinë për Zhvillimin e Investimeve dhe të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Nga ana tjetër, format e mbështetjes nëpërmjet garancive financiare, do të diversifikojnë burimet e financimit në kapitalin e shoqërive vendase dhe rritjen e shpejtë të përmasave të tyre. Projektligji parashikon që në rastet kur, për të mbështetur kreditimin e ndërmarrjeve, në zbatim të politikave të veçanta të Qeverisë, vendoset të lëshohet garanci shtetërore, Këshilli i Ministrave me vendim përcakton fondin, sektorët, kushtet dhe kriteret, për garantimin e huasë për mbështetjen e ndërmarrjeve, me propozim të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për ekonominë. Në vitin e parë janë parashikuar kosto gjithsej 13, 012, 733 lekë, e cila përfshin organizimin e webinarëve për e-business, krijimin e Sektorit të Trajnimeve me 3 punonjës të rinj në strukturën e AIDA, zhvillimin e sistemit të parashikimit të aftësive për bizneset. Në vitin e dytë janë parashikuar kosto gjithsej 99, 369, 454 lekë, e cila përfshin krijimin e portalit për e-business (që shpjegon se çfarë duhet të marrin parasysh kompanitë kur miratojnë zgjidhjet e tregtisë elektronike dhe të biznesit elektronik), grante për ofrimin e trajnimeve dhe mbështetje financiare për ndërmarrjet e sapokrijuara, grante për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si edhe hartimin e raporteve vjetore për parashikimin e nevojave për aftësim nga bizneset. Në vitin e tretë deri në vitin e dhjetë janë parashikuar kosto gjithsej 93, 369,545 lekë, e cila përfshin dhënien e mbështetjes financiare si edhe shërbime mbështetëse për biznesin. Vlera prezente aktuale e kostos në total është 684 mln lekë, ndërsa vlera prezente aktuale e përfitimit në total është 684 mln lekë, duke llogaritur Vlerën Prezente Neto Aktuale (VAN) në shumën prej 0 lekë. Theksojme se ky opsion nuk ka disavantazhe

2. *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
3. *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
4. *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Projektligji vendos rregullat për përgatitjen e raporteve vjetore nga ana e AIDA. Njësitë e qeverisjes qëndrore dhe vetqeverisjes vendore detyrohen që, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të paraqesin pranë Agjencisë përgjegjëse për mbështetjen e ndërmarrjeve raporte vjetore për të gjitha skemat mbështetëse financiare dhe mbështetjen publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të dhëna.

Brenda datës 30 qershor të cdo viti, Agjencia përgjegjëse për mbështetjen e ndërmarrjeve paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë raportin vjetor të vitit pararendës për skemat mbështetëse për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të dhëna.

Gjithashtu në projektligj parashikohet ngritja dhe funksionimi i Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet si një organ këshillimor që ngrihet pranë institucionit përgjegjës për ekonominë, me përfaqësimin e organizatave të ndërmarrjeit si edhe institucioneve shtetërore, i cili është kërkuar në nënkomitetet BE-Shqipëri të viteve të fundit.

Këshilli Konsultativ dhe të këtë si detyrë kryesore diskutimin e çështjeve që lidhen me mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit; nxitjen e bashkëpunimin efektiv ndërmjet organizatave të biznesit/organizatave që mbështesin biznesin dhe organeve shtetërore; këshillimin lidhur me mënyrën e hartimit të skemave mbështetëse për biznesin.

Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur lidhet me mos miratimin e projektligjit brenda periudhës Korrik-Shtator 2021. Kjo pengesë ndikon drejtpërsëdrejti në parashikimet dhe alokimin e fondeve buxhetore për mbështetjen e biznesit në programin e PBA 2022-2024 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”. Në këtë mënyrë

mungesa e një kuadri ligjor do të pengojë realizimin e shumë masave të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe investimeve 2021-2027, që lidhen me ofrimin e shërbimeve mbështetëse për biznesin dhe mbështetjen me grante.

Një pengesë e mundshme për zbatimin e opsionit të preferuar është vonesa në miratimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e masës së përfitimit dhe kriteret dhe kushtet e vecanta të përfitimit nga SME .

### **Faza e monitorimit dhe vlerësimit**

5. *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*

6. *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Projektligji vendos rregulla të reja për përgatitjen e raporteve vjetore nga ana e AIDA. Njësitë e qeverisjes qendrore dhe vetqeverisjes vendore detyrohen që, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të paraqesin pranë Agjencisë përgjegjëse për mbështetjen e ndërmarrjeve raporte vjetore për të gjitha skemat mbështetëse financiare dhe mbështetjen publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të dhëna.

Për shmangjen e ndikimeve negative mbi konkurrencën dhe deformimit të tregut, mbështetja do të jepet në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore dhe vetëm pas miratimit nga strukturat përgjegjëse.

Bazuar në rëndësinë që mbartin, treguesit kryesorë për mbështetjen e ndërmarrjet nga të gjitha organet shtetërore do të jenë:

- Aksesit në treg;
- Aksesit në financë;
- Aksesit në edukim dhe trajnim;
- Aksesit në teknologji dhe inovacion;
- Aksesit të shërbimeve mbështetëse;

Matja e këtyre treguesve (te cilet do të përcaktohen në vendimet e keshillit të Ministrave) do të bëhet pjesë e detyrave funksionale të stafit të AIDA. Treguesit do të vendosen në mënyrë rritese dhe me shtrirje në të gjithë rajonin e Republikës së Shqipërisë.

### **Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a**

***Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.***

Në këtë RIA, kemi llogaritur si kosto për buxhetin e shtetit koston për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në formën e mbështetjes financiare dhe shërbime mbështetëse (trajnim, këshillim ) Konkretisht janë llogaritur si kosto për buxhetin e shtetit shuma për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme nëpërmjet AIDA, në formën e mbështetjes financiare (grante) dhe shërbime mbështetëse (si trajnim, këshillim etj).

- Në vitin 2022 janë parashikuar kosto gjithsej 51, 500, 000 lekë, e cila përfshin grante 50 mln leke, krijimin dhe funksionimin e sektorit të trajnimit 1, 500, 000 leke.
- Në vitin 2023 janë parashikuar kosto gjithsej 53, 000, 000 lekë, e cila përfshin përfshin grante 50 mln leke, funksionimin e sektorit të trajnimit në shumën 3, 000, 000 leke.
- Në vitin 2024 janë parashikuar kosto gjithsej 53, 000, 000 lekë, e cila përfshin përfshin grante 50 mln leke, funksionimin e sektorit të trajnimit në shumën 3, 000, 000 leke.

Më poshtë gjeni përlogaritjen e vlerës aktuale neto të opsionit të preferuar. Vlerat në mijë lekë.



	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Vit i 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
<b>Faktori zbritës</b>	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin - një herë	51,500	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
<b>Kosto në total</b>	51,500	50,350	48,230	46,110	43,460	41,870	39,750	37,630	36,040	34,450
<b>Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës</b>	51,500	47,833	43889	40,116	35,637	33,077	29,812	26717	24,507	22392
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi										
Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										

Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi	51,500	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000
<b>Përfitimet totale</b>	51,500	50,350	48,230	46,110	43,460	41,870	39,750	37,630	36,040	34,450
<b>Përfitimi i zbritur=</b> Përfitimi në total x faktori zbritës	51,500	47,833	43889	40,116	35,637	33,077	29,812	26717	24,507	22339
<b>Vlera prezente aktuale e përfitimit në total</b>	355,427									
<b>Vlera prezente aktuale e kostos në total</b>	355,427									
<b>Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) =</b> Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	0									

## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

*Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni*

Opsioni	Vlera aktuale në mijë lekë		Vlera aktuale neto në mijë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 0	0	0	0
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	355,427	355,427	0

**MINISTËR**

[Emri Mbiemri]